

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 27 JANAR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, u bë e udhës që në çdo seancë plenare që bëjmë të jetë në rendin e ditës miratimi i një, i dy apo më shumë huave. Kjo është vërtet e papranueshme, kur borxhi publik çdo ditë e më tepër rritet dhe kur premtimi elektoral i vitit 2013 kishte si synim uljen e borxhit publik në 60%, pavarësisht se ai sot është më shumë se sa 90%. Nëse i referohemi marrëveshjes së huas të marrë nga KfW-ja, që në total ka një vlerë prej 100 milionë, por do të aprovohen 20 milionë, është një lajm i mirë për studentët, por është një lajm i keq për shqiptarët. Nëse qeveria do të kishte mbajtur premtimin e vitit 2013, duke akorduar 5% të GDP-së, nuk do të kishim nevojë për të marrë hua. Më vjen mirë që kjo kredi prej 20 milionë eurosh do të shkojë për ndërtimin e 19 godinave. Ajo që më tremb është se vlera e eficiencës së kësaj godine shkon më shumë se sa 1 milion euro. Domethënë, vjen era korrupsion, por është e papranueshme kur universitetet e Tiranës, si ai Bujqësor, vuan jo vetëm eficiencën e energjisë elektrike, por në auditorët e leksioneve dhe të seminareve nuk ka energji elektrike. Studentët jo vetëm që nuk kanë mundësi të kenë energji elektrike, por nuk as sistem ngrohje e jo më pas eficiencën e energjisë elektrike në godinat e tyre, madje nuk kanë as godina. U deshën shumë kohë për t'i shembur godinat në këtë universitet, sepse ishin të ndërtuara me tulla silikat për t'i rindërtuar, sepse marzhi i fitimit dhe i korrupsionit ishte më i madh për t'i prishur nga e para se sa për t'i ristrukturuar. Kjo situatë është për të ardhur keq. Nëse arsimit do të kishte pasur 5%, nuk do ta kishim sistemin arsimor kudo në Shqipëri, siç e kemi në Dibër, ku rreth 50% e shkollave janë mbyllur vitet e fundit.

Madje, po të shkosh në ato shkolla, nuk kanë asnjë standard, nuk kanë dyer, nuk kanë dritare, nuk kanë sistem ngrohjeje, madje nuk ka as ngrohje me dru, sepse çmimi i druve është rreth 130 mijë lekë për një metër kub, sepse të drejtën ekskluzive të tregtimit të druve e ka vetëm Librazhdi, pavarësisht resurseve të jashtëzakonshme që ka Dibra. Sot ne do të marrim dy kredi: njëren për eficiencën e konvikteve studentore dhe një kredi tjetër, që ka të bëjë me mbështetjen e reformës në OSHEE, pra të dyja këto kredi bëjnë 150 milionë euro. Domethënë, e thellon edhe më tej borxhin publik, duke e çuar më shumë se sa 90% dhe shumë shpejt, nëse do të marrim edhe borxhin e fshehur, do t'i kalojë termat treshifrorë, pra më shumë se 100%. Nëse qeveria do ta kishte menaxhuar buxhetin e saj, pra nuk do të kishte pasur ato PPP-të e famshme, që kanë vlerën e 430 milionë eurove, nëse nuk do të kishte pasur penalitetet e arbitrazhit ndërkombëtar të gjykatave prej më shumë se sa 388 milionë eurosh, nëse nuk do të kishte qenë çështja "Bechetti" prej 120 milionë eurosh bashkë me pjesën e interesave, jam i sigurt që nuk do të kishim pasur nevojë për të marrë këtë kredi. Sot thuhet se do të merret një kredi për ta reformuar OSHEE-në. Po si ka mundësi që bursa e energjisë elektrike nuk funksionon në Shqipëri? Pse përdoret blerja e energjisë elektrike jashtë bursës, kur i gjithë kuadri ligjor për bursën ishte që në vitin 2015? Pse ngritja e bursës është planifikuar për vitin 2023 për t'u lënë rrugë edhe më tej procedurave korruptive të blerjes së energjisë elektrike? KESH-i vetëm për 9-mujorin e këtij viti ka prodhuar plot 4,5 miliardë kilovatë orë energji elektrike.

Në fakt, i ka shitur OSHEE-së vetëm 3,2 dhe 1,3 e ka shitur në tregun e huaj. Nevojat e konsumit të energjisë elektrike për familjarë dhe konsumatorë të tjerë të biznesit për gjithë vitin janë 4,6 miliardë.

Pra, Shqipëria i ka pasur kapacitet e saj të prodhimit të energjisë elektrike për ta përmbyllur këtë vit, por nuk ka ndodhur kështu, sepse ne kemi blerë më shumë se sa 200 milionë euro energji elektrike, ne kemi shitur energji elektrike, madje nga kompania "NOA Energy Trade", duke bërë shkëmbi energjie, pra duke shitur ditën dhe duke blerë natën që i ka kushtuar buxhetit të shtetit jo pak, por më shumë se sa 9 milionë euro në muaj. Kjo është e papranueshme. OSHEE-ja shkruan se kemi 21% humbje, nëse do të reduktohej kjo 21% humbje, do të kishim energji edhe për 3 muaj të tjerë. Nuk do të kishim nevojë për të blerë energji elektrike. Nëse OSHEE-ja do të kishte mbledhur vetëm borxhin e 5 ujësjellësve në Shqipëri bashkë me Durrësin, do të kishim jo pak por 200 milionë euro për të paguar kredinë e sotme, por edhe kredi të tjera. Sot ne dimë që në OSHEE kemi 3 herë më shumë punonjës se sa 8 vjet më parë, por kemi edhe fondin e pagave 4 herë më shumë se sa 8 vjet më parë, por borxhi i saj në terma absolutë është rritur më shumë se sa 8 vjet më parë. Në fakt, kjo tregohet edhe në standardin e energjisë elektrike që kemi. Po të shkoni në qarkun e Dibrës, mund të shikosh po atë sistem shpërndarje të energjisë elektrike, qoftë me transmetimin apo me kabinat elektrike apo me shtyllat, të cilat janë në kushte mizerabël. Jam i sigurt se kjo është e papranueshme, sepse ne kemi çmimin e energjisë elektrike më të shtrenjtin në rajon, pavarësisht se prodhojmë pothuajse 100% të energjisë elektrike. Bora e këtyre ditëve në këtë qark bëri që të kemi dhjetëra fshatra dhe njësi administrative të bllokuara nga bora, por të kemi edhe me qindra familje pa energji elektrike, sepse nuk ka elektrikist, nuk bëhet hapja e rrugëve, ndërkohë qytetarët detyrohen që të luajnë rolin e OSHEEsë, të bashkisë, të qeverisë, të elektrikistit dhe të braktisjes së shkollës.

Pra, ky është standardi që ka krijuar kjo qeveri në këto vite. Besoj se qeveria nuk është vonë që vitin 2022, ta konsiderojë si një vit risku të lartë madje. Risku më i madh i saj është sidomos pjesa e pandemisë, e cila ka qenë botërore, dhe nuk besoj se ka qenë roli i qeverisë shqiptare për ta shëruar këtë plagë botërore, por qeveria shqiptare në këta 2 vjet që shkuan nuk ka bërë asgjë, nuk ka dhënë asgjë dhe jemi të fundit e rajonit në mbështetjen e biznesit dhe të qytetarëve shqiptarë. Planifikimi për këtë vit është simbolik krahasuar me Kosovën, me Maqedoninë dhe me vendet e tjera dhe jam i sigurt që do të ndikojë ndjeshëm në ekonominë shqiptare. Largimi i fuqisë punëtore është vërtet një tjetër gangrenë, e cila patjetër duhet ta sensibilizojë qeverinë për të gjetur një zgjidhje, sepse paga mesatare e shqiptarëve është më e ulëta në rajon, sepse taksat dhe tatimet janë më të larta në rajon. Sot kërkohet fuqi punëtore, por ato kanë ikur, sepse liberalizimi i tregut ka bërë të mundur që ato të shkojnë në vendet e tjera. Paga e tyre ka ngelur në vend numëro, në vendnumëro ka ngelur paga e punëtorit dhe paga e profesorit. Ne diskutojmë për universitetet, por një profesor merr 2 herë më pak se sa një shofer i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Kjo është e papranueshme. Qeveria duhet të ndërhyjë, sepse situata është vërtet kritike. Nëse qeveria nuk u paraprin këtyre risqeve që unë thashë, atëherë "Rilindja" ngelet realisht një risk i vërtetë për shqiptarët për vitin 2022.